



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **DREJTORIA E ARSIMIT**

**Nr. 05 -398**

**13.12.2016**

**Podujevë**

Bazuar në nenet 7 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr. 04/L-032, Ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ të MASHT nr. 06/2015 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, i datës 10/07/2015, vendimit të ministrit të MASHT-it nr. 214/01B, i datës 23/07/2015, si dhe kërkesave e nevojave për plotësimin e vendeve të lira të punës për mësimdhënës të shkollave fillore, të mesme të ulëta të komunës së Podujevës, drejtori i Drejtorisë për Arsim shpall:

### **Konkurs për mësimdhënës**

1. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Ali Ajeti" Sfeçël,
  - Një (1) mësimdhënës për arsimin fillor,
2. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Dituria" Llapashticë e Poshtme,
  - Një (1) mësimdhënës për arsimin fillor,
3. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Shefki Kuleta" Tërnavë,
  - Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjuhës shqipe, 18 orë në javë,
4. Shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Dëshmorët e Kombit" Podujevë,
  - Një (1) mësimdhënës për lëndën e edukatës fizike, 16 orë në javë,

## **KUSHTET:**

### **I. Kandidatët duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit (i cili merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve, zyra nr. 14 e komunës),
- Certifikata e lindjes,
- Dokumentin personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje),
- Dëshmi mbi kualifikimin (kopja e vërtetuar), ose nostrifikimi i diplomës nëse kandidati ka të kryer ndonjë kualifikim jashtë Republikës së Kosovës,
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT,
- Dëshmi mbi përvojën e punës,
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatët të cilët pranohen në marrëdhënie pune, pra pas publikimit të rezultateve).

### **II. Kushtet dhe kriteret për zgjedhjen e kandidatëve për mësimdhënës**

- Përzgjedhja e kandidatëve bëhet duke u bazuar në kriteret e Ligjeve që e rregullojnë fushën e arsimit: Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-032, Ligji për arsimin dhe aftësimin profesional, nr. 04/L-138, Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, UA. 06/15 Për normativin për kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, vendimin e ministrit të MASHT-it nr. 214/01B, i datës 23/07/2015,.
- **Sqarim shtesë:**
  - Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente gjegjëse,
  - Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHT,
  - Në intervistë ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit, por në mungesë të kuadrit adekuat mund të ftohen edhe kandidatët me kualifikim të përafërt,
  - Kandidatët që konkurrojnë në dy pozita do të intervistohen vetëm për njëren pozitë e që intervista vlen për të dy pozitat,

- Intervista me kandidatë për mësimdhënës do të mbahet sipas orarit të intervistimit i cili do të publikohet me kohë, në tabelën e shpalljeve të Komunës së Podujevës (në hyrje të objektit të komunës),
  - Dokumentet e pakompletuar dhe ato që arrijnë pas afatit nuk shqyrtohen,
  - Dokumentet dorëzuar nuk kthehen.
- **Afati i konkursit**  
Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve të objektit të Komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>.

Drejtori



---

Avni Maloku, Msc.

